

V E N D I M
Nr. 393, datë 20.7.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 27.2.1992, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, NË VENDIMIN NR.54, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
DHE NË VENDIMIN NR.56, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit e ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.60, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve”, bëhen këto ndryshime:

a. Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës 7 018 lekë në muaj, kurse paga më e lartë (drejtor drejtorie) bëhet 29 700 lekë në muaj.

b. Në pikën 2, paga e ushtarakëve, nxënësve dhe studentëve ushtarakë bëhet 847 lekë në muaj.

c. Në pikën 5, paragrafi 3, paga për ushtarin rezervist bëhet deri 605 lekë në ditë.

ç. Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- Shef i Shtabit të Përgjithshëm	70 785 lekë
- Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm	55 539 lekë
- Drejtor i Përgjithshëm	57 596 lekë
- Shef i kabinetit të ministrit	54 208 lekë
- Këshilltar i ministrit	45 617 lekë

2. Në vendimin nr.54, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik dhe ushtarakëve të Ministrisë së Drejtësisë”, bëhen këto ndryshime:

a. Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bëhet 7 018 lekë në muaj dhe niveli më i lartë bëhet 30 558 lekë në muaj.

b. Në pikën 3, paga e ushtarakëve të shërbimit të detyrueshëm dhe studentëve të shkollave të Ministrisë së Rendit Publik bëhet deri në 847 lekë në muaj.

c. Për ushtarakët e sistemit të Ministrisë së Rendit Publik, paga e të cilëve është përcaktuar me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave (jashtë sistemit të pagave me klasa), rriten 10 për qind.

ç. Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- Drejtor i Përgjithshëm i Policisë	67 155 lekë
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë	60 808 lekë
- Komandant i Gardës së Republikës	60 808 lekë
- Drejtor i Policisë së Burgjeve	52 635 lekë

3. Në vendimin nr.56, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve në Shërbimin Informativ Kombëtar”, bëhen këto ndryshime:

a. Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bëhet 7 018 lekë në muaj dhe niveli më i lartë (drejtor drejtorie) bëhet 29 700 lekë në muaj.

b. Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- Drejtor i Shërbimit Informativ Kombëtar	90 750 lekë
- Zëvendësdrejtor i Shërbimit Informativ Kombëtar	61 710 lekë
- Inspektor i Përgjithshëm Informativ Kombëtar	61 710 lekë

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen, në përputhje me pikën 1, të aktit normativ nr.1, datë 14.7.2000, “Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja e pagave dhe pensioneve”.

5. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta